



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Psikologji Zhvillimi

Ngarkesa: 4 kredite; 45 orë mësimore; 30 leksione / 15 seminare
Viti / Semestri : Viti I, Semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i Shkencave në “Mësuesi e gjuhës italiane”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike mbi zhvillimin fizik, kognitiv dhe psikosocial gjatë moshës shkollore dhe adoleshencës. Të aftësojë studentët për të kuptuar ndikimin e faktorëve të ndryshëm në zhvillimin e personalitetit dhe sjelljes së nxënësit në moshën shkollore. Të përgatisë studentin-mësues për të përshtatur procesin mësimor në funksion të nevojave zhvillimore të nxënësve.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të analizojë dhe të krahasojë teoritë kryesore të zhvillimit njerëzor si bihejviorizmi, konstruktivizmi dhe psikosocialja.
2. Të identifikojë ndryshimet dhe tiparet kryesore të zhvillimit fizik, kognitiv dhe emocional gjatë periudhave të fëmijërisë dhe adoleshencës.
3. Të vlerësojë ndikimin e faktorëve psikosocialë në formimin e personalitetit dhe sjelljes së fëmijëve dhe adoleshentëve në kontekstin edukativ.

Rezultatet e pritshme:

1. Studenti përshkruan me saktësi proceset dhe etapat e zhvillimit fizik, kognitiv dhe psikosocial të fëmijëve dhe adoleshentëve.
2. Studenti demonstroi njohuri për teoritë themelore të zhvillimit njerëzor dhe zbaton konceptet përkatëse në situata konkrete arsimore.
3. Studenti është në gjendje të analizojë faktorët që ndikojnë negativisht në zhvillimin e adoleshentëve dhe të propozojë ndërhyrje edukative të përshtatshme.